


PROGRAM TRAJNIMI I VAZHDUAR

Kursi i II: *Menaxhimi i Financave Vendore*
Tirane 27-28 Tetor 2016

Pergatiti Lindita Oshafi-Eksperte e pavarur
linditaoshafi@yahoo.com

Procesi aktual i planifikimit dhe menaxhimit të politikave dhe financave publike



SESIONI 1:


TE ARDHURAT VENDORE DHE PLANIFIKIMI I SHPENZIMEVE VENDORE

Pergatiti Lindita Oshafi-Eksperte e pavarur
linditaoshafi@yahoo.com

Ceshtjet

- ❑ Planifikimi i të ardhurave për njësitë e qeverisjes vendore
- ❑ Planifikimi i të ardhurave si pjesë e manaxhimit financiar të NJQV-s
- ❑ Burimet e të ardhurave dhe parashikimi i të ardhurave
- ❑ Planifikimi i shpenzimeve dhe Vlerësimi i shpenzimeve në bazë të IPF-së
- ❑ Prezantimi i vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve

Cikli i menaxhimit financiar_Planifikimi i te ardhurave




Marrëdhëniet të ardhura/shpenzime në PBA

Kuadri fiskal

2017 2018 2019


Paketa Fiskale (afatmesëm)

- Taksat/Tarifat etj
- Tavanet e programeve



Kuadri Fiskal afatmesëm
(politikat e lidhura me të)

Shpërndarja e Burimeve



Shpenzimet sipas programeve dhe prioriteteve të PSZH-së në periudhën afatmesme

PBA: Programi Buxhetor Afatmesëm

Parashikimi afatmesëm

Performanca e Buxhetit

Dokumenti

Menaxhimi Performancës

- Monitorimi; Vlerësimi
- Auditimi
- Raportim

PBA bazuar ne indikatorë :

- ❖ Inpute
- ❖ Outpute
- ❖ Outcomet
- ❖ Eficencën

Planifikimi i te ardhurave

- Kushtetuta e RSh :
 - ✓ Njqv-të janë persona juridikë. Ato kanë buxhet të pavarur, i cili krijohet në mënyrën e parashikuar me ligj”.
 - ✓ Neni 113 i Kushtetutës, germa “c” parashikon si garanci kushtetuese të drejtën e Këshillave Vendore:
 - Të mbledhin të ardhura.
 - Të shpenzojnë të ardhurat që janë të domosdoshme për ushtrimin e funksioneve të tyre.

- Ligji 139/2015 “Për veteqeverisjen vendore” në nenin 34, 35, 36 të tij përcakton burimet e financimit të NjqV
 - ✓ të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifatat dhe të ardhurat e tjera vendore,
 - ✓ nga fondet e transferuara nga qeverisja qendrore dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare,
 - ✓ huamarrja vendore,
 - ✓ donacione, si dhe burime të tjera

Parimet e qeverisjes së mirë për mobilizimin e të ardhurave

Parimi i përfitimit	Nese paguaj, duhet te perfitoj sherbim. Por, jo të gjitha shërbimet financohen në bazë të parimit.
Parimi i Drejtësisë	Përdoruesit me aftësi të ngjashme duhet të paguajnë shuma të ngjashme
Parimi i Neutralitetit	Taksat/tarifat nuk duhet të favorizojnë ndonjë grup apo sektor në raport me një tjetër.
Parimi i Përgjegjshmërisë	Te qartë për taksapaguesit se sa duhet të paguajnë dhe përse i përdor paratë qeveria.
Parimi i Përshtatshmërisë dhe stabilitetit	Të ardhura të mjaftueshme për të financuar shërbimet bazë rregullisht dhe ne vazhdimësi, të ardhura të qëndrueshme dhe të parashikueshme.
Parimi i Autonomisë	NjQV kanë nevojë për autonomi dhe fleksibilitet për të vendosur prioritetet e tyre. Ato duhet të minimizojnë varësinë e tyre nga të ardhurat e QQ.
Parimi i minimizimit të kostove administrative	Llogaritja, vlerësimi, mbledhja dhe administrimi i tarifave/taksave nuk duhet të konsumojë kohë as për qeverinë dhe as për taksapaguesin.
Parimi i thjeshtësisë	Vlerësimi tatimor duhet të jetë lehtësisht i kuptueshëm, përjashtimet të jenë të kufizuara dhe të kenë një arsye të qartë.

Parashikimi i te Ardhurave

- **E rëndësishme :**
 - Te njohesh ligjet kryesore
 - Te aplikosh modele te ndryshme parashikimi
 - Te shfrytezosh te dhenat e viteve te meparshme
 - Te njohesh faktoret me ndikim te ndjeshem
 - Te zoterosh informacione dhe te dhena aktuale
 - Te shfrytezosh eksperiencen personale dhe ate prezent

Baza ligjore kryesore per sistemin tatimor

- Ligji 139/2015 “Për veteqeverisjen vendore.”
- Ligji 9632 dt. 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar nga Ligji 10117 dt. 23.04.2009; Ligji 10146 dt. 28.09.2009, Ligji 10073, dt 09.02.2009, Ligji 10354 dt. 18.11.2010 “Për disa ndryshime në Ligjin 9632 dt. 30.10.2006.”
- Ligji 9723 dt. 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.”
- Ligji 9920 dt. 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.”
- Ligji 9869 dt. 04.02.2008 “Për huamarrjen e QV.”
- Ligji 9936, 26.06.2008, “Për manaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”

Baza tjeter ligjore për sistemin tatimor

- V.K.M. nr. 1058 dt. 21.10.2009 “Për kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në.”
- Udhëzim nr. 35, datë 5.11.2008, “Për zbatimin e Ligjit Nr. 9869, datë 04.02.2005, “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore.”
- Udhëzimi 7/1, 29.02.2012 “Për përgatitjen e buxhetit vendor.”
- Ligji 10487, 05.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012.”
- Udhëzim shtesë 2/1, 15.02.2012 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2012.”
- Udhëzim shtesë 7/2, 01.08.2012 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm për 2013-2015.”
- Udhëzimi 1, datë 11.01.2008 “Për tatimin mbi të ardhurat.”
- Ligji Nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare.”

Burimet e te ardhurave te PV

- Sipas legjislacionit aktual (Ligji Nr. 139/2015, “Për veteqeverisjen vendore” dhe Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”), burimet financiare të NJQV-së përbëhen nga të mëposhtmet:
 - Taksat vendore
 - Tarifat vendore
- Grantet nga buxheti qendror, të cilat janë:
 - Të pakushtëzuara
 - Të kushtëzuara
 - Fondi i Zhvillimit Rajonal (grantet konkurruese që përdoren për financimin e projekteve kapitale)
- Të ardhurat e tjera, mbi të cilat njësitë e qeverisjes vendore kanë autoritet të plotë manaxhimi.
- Huamarrja e qeverisjes vendore.
- Donacione apo kontribute të ndryshme.

Taksat

- Detyrim tatimor qe nuk lidhet me nje sherbim specifik.
- Në procesin e planifikimit të të ardhurave mbeshteten:
 - Kategoria e taksave – përcaktuar me ligj
 - Baza tatimore – që është specifike për secilën taksë apo tarifë
- Niveli i taksës – shmangie përqindjeje prej +10/-30% nga vlera treguese.

Te ardhurat nga taksat

❖ I mbledh vete Bashkia/ose zgjedh agjentin

- ❑ Taksa mbi pasurinë e paluajtshme
 - ❑ *Taksa mbi ndërtesën.*
 - ❑ *Taksa mbi tokën bujqësore.*
 - ❑ *Taksa mbi truallin*
- ❑ Taksa e fjetjes në hotel.
- ❑ Taksa ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.
- ❑ Taksa e tabelës dhe reklames.
- ❑ Taksa të përkohshme.

❖ Taksa te perbashketa

- ❑ Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogël.
- ❑ Taksa mbi kalimin e te drejtes se pronësisë per pasurite e palujtshme.
- ❑ Taksa e mjeteve te perdorura.
- ❑ Taksa e rentës minerare.

Tarifat

- Eshtë një kontribut i kërkuar për t'u paguar nga çdo person, i cili drejtpërdrejt përfiton një shërbim publik.
 - Reflekton koston/mbulon koston
 - QV Kompetence te plote per vendosjen e llojeve, baze dhe nivelit.
-
- Shërbimet publike të ofruara, si: pastrimi, ndriçimi, gjelbërimi etj.
 - Shërbime administrative.
 - Të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore.
 - Dhënien e licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë.

Te ardhura te tjera vendore

- **Te ardhura nga burime te tjera**
 - të ardhurat nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë;
 - të ardhurat nga investimet mbi kapitalet;
 - të ardhurat nga titujt dhe të drejtat e tjera të blera nga bashkia;
 - të ardhurat nga fitimi i ndërmarrjeve publike në pronësi;
 - të ardhurat nga partneritetet privat-publik.
- **Të ardhura nga veprimtaritë e tyre ekonomike, qiratë dhe shitja e pronave, dhuratat, interesat, gjobat, ndihmat ose donacionet.**
- **Të ardhura nga veprimtaritë e tyre kulturore, sportive dhe të tjera, të përcaktuara me ligj.**
- **Gjoba**

Vecori te sistemit tatimor

- ❑ Baza tatimore duhet të jetë transparente dhe të mbështetet në të dhëna të qëndrueshme.
- ❑ Baza tatimore duhet të jetë lehtësisht e aplikueshme dhe e administrueshme.
- ❑ Të ardhurat nga sistemi tatimor duhet të jenë të mjaftueshme për të mbuluar nevojat vendore. Te ardhurat tatimore duhet të rritet gradualisht me kalimin e kohës.
- ❑ Taksa/tarifa duhet të jetë e perceptueshme nga taksapaguesit si e arsyeshme dhe e drejtë.

Transfertat

- Të ardhura, të cilat i jepen NJQV për te permbushur funksionet ligjore.
- Transfertat e pakushtëzuara janë të ardhura pa kthim/mbarten vitin pasardhes. NJQV-të kanë autoritetin për të ndarë të ardhurat nga TPK.
- Transfertat e kushtëzuara- jepen per funksionet e deleguara me destinacion. Nuk mbarten ne vitin pasardhes.
- Grante konkurruese/FZHR- per projekte kapitale

Formula e shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar

Është përdorur një formulë dhe ky instrument është faktor stabilizues i financave vendore

Formula merr në konsideratë disa kriterë kryesorë dhe të tjera plotësuese që synojnë:

Objektivitet; Parashikueshmeri; Barazi dhe Transparencë

Kriteret kryesorë:

Numri i popullsisë,

Dendësia e popullsisë

Numri i nxenesve


Kriteret plotësuese:

Ekualizimi fiskal

Kriter specifik për varfërinë dhe kushtet gjeografike të ndryshme

Garancia minimale për frymë

Formula e shperndarjes se transfertes se pakushtezuar ne buxhetin 2016



Huamarrja vendore

- Eshtë një tjetër instrument i financimit të aktivitetit ekonomik të NjQV. Mbeshtet me ligjin nr. 9689/2008.

NjQV mund të marrin hua:

- Në tregun Financiar brenda vendit
 - Në tregun Financiar ndërkombëtar
 - Per të financuar **mungesën e përkohëshme të likuiditeteve**
 - Financuar **shpenzime kapitale**
 - **Rifinancuar** hua afatgjatë ekzistuese
-
- **Nisur nga koha e maturimit, huatë mund të jenë:**
 - Hua afatshkurtër
 - Hua afatgjatë

Manaxhimi i taksave/tarifave vendore (fiskal)

- **1. Kerkon nje kuptim me te plote te
autonomise fiskale:**
 - A kemi kapacitete te mundshme
 - A jemi eficente ne perdorimin e te ardhurave.
 - A do te kemi fonde te lira ne vitet e mepasme
 - A po rritim investimet ne komunitet
 - A shihen e maten ndryshimet nga qytetaret

Manaxhimi i taksave/tarifave vendore (fiskal)

□ **2.Kerkon nje permiresim te konceptit te manaxhimit te taksave/tarifave:**

- Politikat
- Administrimin
- Te dhenat

Konceptet kryesore te politikave

- Analiza e performances se meparshme (3 vjet)
(ardhura,nivele,baze)
- Ndikimi i trendave ekonomike e demografike
(teknologjia e informacionit)
- Analiza e aftesise per te paguar (profili social I familjes e bizneseve)
- Ndryshimet ligjore

Pergatit opsione te politikave per shqyrtim

Matrica fiskale

	Politika	Administrimi	Te dhenat
Baza e takses/tarifesh	Cfare?	Implikime/Impakto	Cfare te dhenash na duhen
Niveli i takses/tarifesh	Sa?	Llogaritja, pagesat	per te vendosur per politiken
Taksapaguesi	Kush jane?	Identifikimi, lajmerimi, derdhja e detyrimeve ankimi	dhe administrimin

I.Politika Fiskale (1)

□ Cfare eshte nje politike fiskale?

□ Te vendosesh bazen dhe nivelin e takses

□ Duke konsideruar:

- Nevojen per fonde: me shume fonde per shume sherbime me te mira
- Trendet demografike / ekonomike: inflacioni, rritja, kostot
- Incentivat: me mire nese paguan
- Mundesine: Kush mund te paguaje, paguan

□ **A mund te vendosim per politiken pa patur te dhenat e nevojshme?**

INFORMACIONI



- Cfare te dhenash posedoj?
- Si po i perdor keto te dhena?
- A me duhen te dhena te reja per politiken e re fiskale?
- Sa me duhet te shpenzoj per te dhenat e reja?
- A ia vlen? Nese po, investo ne sistemin e te dhenave
- Nese jo, politika duhet t'i pershtatet te dhenave qe kam.

I.Politika Fiskale (2)

Kur mendojme per politika



- **Nevoja per te ardhura**

- Rritja e sasise dhe/ose cilesise se sherbimeve aktuale

- Ofrim i sherbimeve te reja

I.Politika Fiskale (3)

□ **Trendet demografike dhe ekonomike**

- Ndryshimi i popullsisë (+/-). Cilat janë implikimet
 - Mbi shpenzimet, mbi potencialin e të ardhurave
- Efekti i inflacionit, rritmeve ekonomike në bazën dhe nivelin e takses ose kostot e shërbimeve
- Faktore të tjera që ndikojnë në potencialin e të ardhurave apo në kostot e shërbimeve

I.Politika Fiskale (4)



□ Incentivat perkundrejt ndeshkimit

- Paraja e shpenzuar mire eshte nxitesi me i mire
- Transparence, konsultim, pjesemarrje
- Zbatim i drejte dhe i ndershem.

I.Politika Fiskale (5)

□ **Mundesia (1)**

- Kush janë taksapaguesit? Nderto profilin e segmenteve tipike
- Sa janë te ardhurat e tyre?
- Sa janë shpenzimet e tyre?
 - Cilat janë detyrimet e tjera të tyre (taksa, tarifa vendore dhe kombetare)?
- Llogarit efektin e pritshëm të një politike të re të takses mbi taksapaguesit
- A mund të paguajne ata? Cfare përjashtimesh/lehtesirash nevojiten?
- Rishiko politiken

I.Politika Fiskale (5/1)

- **Mundesia (2)-profili i nje familjeje tipike ne kushte “nen mesataren”**
 - Pensionistesh, pensioni mesatar mujor – 10,000 lek/muaj
 - Profili i nje familje me nje/dy te papune
 - Profili i nje familjeje me ndihme ekonomike
 - Profili nje familjeje me paga buxhetore. Paga mesatare: 22,000 lek/muaj
- **Sa jane shpenzimet per sherbime baze.**
 - Po pesha e taksave dhe tarifave te tjera?
- **A mund t'i lehtesojme? Sa? Si?**

II.ADMINISTRATION (1)



- Numri dhe koha e pageses: fluksi i parase per bashkine perkundrejt atij te taksapaguesit
- Identifikimi, regjistrimi i taksapaguesve, informimi ne kohe i tyre
- Ndjekja e dinamikës së mbledhjes së të ardhurave. Ku dhe pse nuk po ecen arketimi?
- Pagesa: vendi, koha e shërbimit
- Ankimi

II.ADMINISTRATION (2)



- **Ndjekja e dinamikes se mbledhjes**
 - Si po shkon arketimi ne raport me parashikimin. Po me nevojat?
 - Cfare po ndodh? A kemi zona apo grupe tipike qe nuk po paguajne? PSE?
 - Si po veprohet per identifikimin/regjistrimin e taksapaguesve te rinj?

II. ADMINISTRATION (3)

□ **Shmangjet nga detyrimi**

□ Kupto aresyet e mospagimit

- Konsidero se gabimi mund te jete edhe i juaji

□ Ndeshkimi: zgjidhja e fundit,

- konsidero mundesite per zbatimin e ndeshkimit
- Ne proporcion me demin e shkatuar

□ Mundesi apelimi:

- Te mundeshme per t'u perdorur nga taksepaguesi
- Te drejte dhe te paanshem
- Mundesisht, para dates se shlyerjes se detyrimit

Kush i jep kuptim paketes fiskale



- Politikat fiskale (cfare,sa,kush paguan)
- Administrimi (implikimet e propozimeve)
- Te dhenat (cfare disponojme e na duhen)

Autoriteti i Keshillit

□ **Per taksat**

- ✓ Vendos për nivele të ndryshme sipas nivelit të zhvillimit të veprimtarisë së biznesit, xhiros, dhe vendit të ushtrimit të aktivitetit në zona të ndryshme të qendrës së banuar, në kufijtë +10/-30% të nivelit tregues të përcaktuar nga ligji.

□ **Per tarifat**

- ✓ Duhet të mbulojnë koston e shërbimeve të përdorura nga përfituesit, vendos keshilli per nivelin e tyre.

Politika te keshillit _te ardhurat

- Shpërndarja e mundshme dhe masat për mobilizimin e te ardhurave
 - Aplikimi i tarifave të diferencuara për nënkategori të ndryshme taksapaguesish brenda së njëjtës kategori (barazia vertikale).
 - Aplikimi i bonusit për pagesat në avancë (10% ulje për pagesa vjetore).
 - Përfshirja e grupeve të ndryshme taksapaguese.
 - Rritja ose ulja e nivelit të taksës.
 - Përmirësimi i administrimit të taksave dhe vjeljes së taksave.
 - Parandalimi i mashtrimit.

Pyetje

- A keni një paketë fiskale të miratuar për periudhën 3- vjeçare në qeverinë tuaj vendore? A keni pasur në të kaluarën?
- Cila është politika e paketës fiskale të njqvs-së suaj në lidhje me grupe të ndryshme taksapaguese?
- Cili ka qenë ndikimi i paketës fiskale tek të ardhurat?
- A ka ndikime të tjera të favorshme apo të pafavorshme të paketës fiskale për t'u marrë parasysh në lidhje me parimet e qeverisjes së mirë të mobilizimit të të ardhurave apo të karakteristikave të taksës së mirë?



- Shembull, prezantimi i paketes fiskale

Struktura dhe permbajtja e paketes fiskale

- **Permbajtja e paketes**
- **Te pergjithshme mbi Bashkine, pozicionin, harte, NjA etj**
- **Grupi i punes per paketen**
- **Raport i shkurter i takimeve me publikun, propozime, foto etj.**
- **Kuadri ligjor dhe n/ligjor**
- **Kapitulli per taksat**
 - *Perkufizimi*
 - *Baza e taksës*
 - *Niveli (ligjor dhe propozimi) per cdo kategori, per cdo NjA*
 - *Mënyra e pagesës*
 - *Komente per cdo kategori/sqarime te hollesishme*
 - *Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës*
 - *Kategorite qe perjashtohen*

Struktura dhe permbajtja e paketes fiskale

□ **Kapitulli per tarifat**

- *Perkufizimi*
- *Baza e tarifes*
- *Niveli mesatar per mbulimin e koston dhe propozimi per cdo kategori, per cdo NjA*
- *Mënyra e pagesës*
- *Komente per koston e sherbimit publik te ofruar dhe politikat per mbulimin e saj nga cdo kategori*
- *Strukturat përgjegjëse për vjeljen e tarifes*
- *Kategorite qe perjashtohen*

□ **Kapitulli per gjobat**

□ **Agjentet per mbledhjen e detyrimeve / perfitimi i tyre**

Shembull: Niveli i takses

Nr.	Kategoritë dhe nënkategoritë	Njësia	Niveli i Taksës mbi ndërtesat			
			NjA Lezhe		Nja te Tjera	
			Sipas ligjit	Propozimi	Sipas ligjit	Propozimi
I.2.1	Ndërtesa banimi					
a	Ndërtuar para vitit 1993 (për shtëpinë ku kanë banimin e zakonshëm)	lekë/m2/vit	10	10	5	5
b	Ndërtuar gjatë dhe pas vitit 1993 (për shtëpinë ku kanë banimin e zakonshëm)	lekë/m2/vit	12	12	6	6
c	Ndërtesa në pronësi të shoqërive të ndërtimit të pashitura, por të hipotekuara si ndërtesa banimi	lekë/m2/vit	12	12	6	6
d	Ndërtesa të dyta banimi (për të gjitha shtëpitë e tjera)	lekë/m2/vit	24	24	12	12
I.2.2	Ndërtesa të tjera					
a	Për tregti dhe shërbime - Ndërtesa për shërbime shëndetsore, artizanale, social kulturore, arsimore e shkencore. - Ndërtesa për shërbime tregtare, administrative etj.	lekë/m2/vit	300	250	200	180
b	Të tjera - Ndërtesat në pronësi të organizatave jofitimprurëse, fondacioneve - Objekte të amortizuara, të dëmtuara dhe jashtë funksionit kur janë objekte të ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-ndërmarrjeve shtetërore të privatizuara ku nuk zhvillohet aktivitet.	lekë/m2/vit	60	42	40	28
c	Ndërtesa që përdoren për veprimtari prodhuese	lekë/m2/vit	150	125	100	90
d	Ndërtesa në pronësi të shoqërive të ndërtimit të pashitura, por të hipotekuara si ndërtesë biznesi	lekë/m2/vit	300	300	200	200


Niveli i tarifes sipas kosos dhe propozimi

<i>Familjet</i>	<i>Politika per cdo NjA</i>	<i>100%</i>	<i>47%</i>	<i>53%</i>
Politikat e mbulimit kosos	Kosto e sherbimeve publike	Totali I kosos/leke 20,518,000	NjA B.Curri	NjA te Tjera
65%	Familjet	13,336,700	6,268,249	7,068,451
	Tarifa mesatare	1,470	2,422	1,090
<i>Biznesi I madh</i>	<i>Politika per cdo NjA</i>	<i>100%</i>	<i>30%</i>	<i>70%</i>
15%	Biznesi i Madh	3,077,700	1,446,519	1,631,181
	Tarifa mesatare	60,347	55,635	65,247
<i>Biznesi I vogel</i>	<i>Politika per cdo NjA</i>	<i>100%</i>	<i>81%</i>	<i>19%</i>
15%	Biznesi i Vogel	3,077,700	1,446,519	1,631,181
	Tarifa mesatare	8,409	4,887	23,303
<i>Institucionet</i>	<i>Politika per cdo NjA</i>	<i>100%</i>	<i>100%</i>	<i>-</i>
5%	Institucionet	1,025,900	1,025,900	
	Tarifa mesatare	39,458	39,458	39,458


Taksa dhe Tarifa direkt _ cdo muaj/familje

Nivelet e propozuara	NjA B.Curri		NjA te tjera	
	Leke/vit	Leke/muaj	Leke/vit	Leke/muaj
Taksa mbi banesen	245		200	
Taksa mbi token bujqesore	800		720	
Taksa mbi truallin	10		14	
Tarifa e Sherbimeve	2,200		1,100	
SHUMA	3,255	271	2,034	170

Taksa e Tokes Bujqesore (Leke/ha_ulje -10%)



Tarifa e Sherbimit sipas NjA _ulje krahasuar v.2016



Taksa dhe Tarifa direkt _ cdo muaj/biznes vogel

Nivelet e propozuara	NjA B.Curri		NjA te tjera	
	Leke/vit	Leke/muaj	Leke/vit	Leke/muaj
Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	10,000		10,000	
Taksa mbi ndertesen	7,000		3,500	
Taksa mbi truallin	600		600	
Taksa e tabeles	120		120	
Tarifa e Sherbimeve	25,000		13,500	
SHUMA	42,720	3,560	27,720	2,310

Ceshtjet

- ❑ Burimet e të ardhurave dhe parashikimi i të ardhurave
- ❑ Planifikimi i shpenzimeve dhe Vlerësimi i shpenzimeve në bazë të IPF-së

Burimet e te ardhurave

□ **Burimet e te Ardhurave**

I. **Nga buxheti i shtetit**

- Transferta e pakushtezuar
- Transferta e kushtezuar, specifike
- Grante konkurruese/Fondi Zhvillimin e Rajoneve

II. **Te ardhura qe i mbledhin vete**

- Taksat , Tarifat vendore, Te ardhura te tjera

III. **Taksat e perbashketa - i mbledhin te tjeret per bashkine**

IV. **Donacione/partneritete**

Projektimi i te ardhurave nga taksat (1)



- Analizo te shkuaren
- Perdor studime dhe hipoteza te besueshme per te ardhmen
- Parashiko me objektivitet
- Perdor skenar alternativ dhe zgjidhje alternative

Metoda - Parashikimi i te ardhurave

- **Gjykimi i ekspertit** - prodhon parashikime të arsyeshme dhe të sakta si dhe kushton pak, deshton nese largohet
- **Vlerësimi i trendit** - mbështet në ndryshimet/trendin vit pas viti të një burimi të caktuar të ardhurash apo shpenzimesh; ky trend llogaritet me anë të metodave statistikore-ku kur mjedisi tatimor nuk ndryshon
- **Parashikimi determinist** - parashikimi bazohet në marrëdhënien fikse (formula) midis variabëlve të vëzhguara (inpute) dhe variabëlve të llogaritur (output). Kjo teknikë quhet përcaktuese pikërisht në saje të kësaj lidhjeje fikse. E thjeshte-varet nga saktësia e formules, variablave (lejat)
- **Parashikimi ekonometrik.** Ky model parashikimi kombinon parashikimet ekonomike me metodat statistikore duke u bazuar në një model shumëdimensional – konsideron dhe faktore te jashtemi rritja e popullsisë, cikli I biznesit, inflacioni etj -kompleksiteti e saj

Rekomandohet që keto pasiguri të bëhet prezente në PBA.

Kjo mund të bëhet duke përdorur teknikën e skenarëve.

Skenaret ne planifikimin e te ardhurave

- **“Pesimist”** - kapacitete financiare të pamjaftueshme në përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave të programeve (prioritetet e planit strategjik). Merren vendime si të shkurtohen shpenzimet me qëllim që të balancojme buxhetin.
- **“Realist”** - supozon se të ardhurat e njësisë vendore do të mjaftojnë për arritjen e përparësive/prioriteteve strategjike.
- **“Optimist”** - konsideron eliminimin e të gjithë faktorëve negative. Financat vendore do të jenë të bollshme sipas skenarit dhe do të ketë vend për financimin edhe të projekteve me përparësi të ulët.

Projektimi i te ardhurave nga taksat (2)

- Taksa e baneses /nderteses
 - Analizo te shkuaren: Sa eshte mbledhur ne te shkuaren, kush ishin faktoret e ketij niveli?
 - A pritet nje rritje e numrit te banesave? Cilat kategori? Sa mund te jete rritja
 - Sa mund te ulim nivelin e mosregjistrimeve?
 - Si te matim vete siperfaqen e deklaruar apo te padeklaruar?

PERGATITJA E POLITIKES FISKALE

□ **Faza e pare e pergatitjes**

- Diskutimi dhe adoptimi i alternativave me thelbesore. Ka nje natyre kryesisht strategjike
- Kryesisht ne periudhen Korrik-shtator

□ **Faza finale e pergatitjes**

- Projekt vendim i detajuar dhe i mbeshtetur
- Para fundit te vitit

FAZA E PARE (e hereshme) E PERGATITJES

- E rëndesishme pasi
 - ▣ Nis ne kohe procesin e diskutimit politik dhe komunitar te opsioneve
 - ▣ Arrin te identifikojë alternativat dhe te percaktojë zgjedhjet e pranueshme
 - ▣ Vendos nje radhe prioritetesh te alternativaveqe mund te shqyrtohen
 - ▣ Orienton me mire punen e thelluar te analizave dhe te projektit/ve te politikës

Kalendari Fiskal

Janar	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Nentor	Dhjetor
Prill					Tetor		
<div data-bbox="128 699 401 841" style="border: 1px solid black; background-color: #d9e1f2; padding: 5px; margin-bottom: 10px;"> Mbledhja e Taksave/ </div> <div data-bbox="417 842 823 932" style="border: 1px solid black; background-color: #d9e1f2; padding: 5px; margin-bottom: 10px;"> 1.Mendime nga qytetaret 2.Departmentet </div> <div data-bbox="827 946 1230 1023" style="border: 1px solid black; background-color: #d9e1f2; padding: 5px; margin-bottom: 10px;"> Projekti ne M.Financave Te politikave/ardhurave </div> <div data-bbox="1094 1049 1623 1226" style="border: 1px solid black; background-color: #d9e1f2; padding: 5px; margin-bottom: 10px;"> Pergatitja e Draftit te Politikave Diskutimi me komisionin ekonomik Paraqitja ne publik </div> <div data-bbox="1415 1279 1719 1385" style="border: 1px solid black; background-color: #d9e1f2; padding: 5px; margin-bottom: 10px;"> Miratimi nga keshilli Publikimi I paketes </div> <div data-bbox="1703 1386 2003 1479" style="border: 1px solid black; background-color: #d9e1f2; padding: 5px;"> Keshilli miraton Buxhetin/Ardhurave </div>							

BAZA E TE DHENAVE



- Politika e vitit paraardhes atij korrent
- Rezultatat e te ardhurave per keto dy vite (dhe me pare)
- Analiza e forces, mundesive, dobesive dhe kercenimeve
- Analiza e nevojave
- Rezultatat e konsultimeve me komunitetin (nese jane bere)

CESHTJA KRYESORE



- Sa dhe Si mund te rriten te ardhurat e bashkise?
 - ▣ Transferta perkundrejt te ardhurave vendore
 - ▣ Forma te tjera te krijimit te te ardhurave
- Per te perballuar nevojat ne rrije te shpenzime per me shume sherbime te kerkuara nga komuniteti

OPSIONE PER DISKUTIM

- Si mund te rrisim te ardhurat pa rritur nivelin per taksat apo tarifat.
 - A kemi evazion? C'mund te behet per te ulur ate?
 - A kemi nje percaktim te paqarte te bazes se takses/tarifes
 - A ka mundesi qe te rritet baza e takses per shkak te trendeve pozitive
- Cili do te ishte rezultati i priteshem i te ardhurave nga ky skenar.

OPCIONE PER DISKUTIM



- Do te fokusohemi ne taksat apo kemi me shume rezerva ne tarifat?
 - Cilat jane argumentat dhe efektet e priteshme
 - A jane tarifat me te pershtateshme per te finacuar disa shpenzime per sherbime te drejtperdrejta
 - Ndersa taksat per te siguruar nje financim te qendrueshem dhe baze?

OPCIONE PER DISKUTIM



- A ka taksa dhe/ose tarifa qe jane ne nivele te uleta?
 - ▣ A ka rezerva te fshehura ne ndonje prej tyre?
 - ▣ Cilat jane rezultatat e analizes se kostos se nje sherbimi perkundrejt tarifes se tij?
 - ▣ Cila eshte pesha e nje takse mbi nje taksapagues

ZGJEDHJA E POLITIKES

- E Rekomandueshme te arrihet nje konsensus fillestar i pranueshm me keshillin dhe komunitetin
 - ▣ Ne lidhje me opcionin e politikes...
 - ▣ Ose te pakten ne lidhje me radhen e shqyrtimit te opsioneve...
 - ▣ Sipas shkalles se kenaqjes se kerkesave per sherbime...
- Perpara se te filloje pergatitja e projekt-buxhetit te vitit pasardhes (apo ndoshta tre vjecar!)

Politika e te ardhurave

- Hapat qe duhet ndermerren:
 - Gjendja e të ardhurave të viteve të mëparshme (2-3) dhe të vitit ekzistues.
 - Shpenzimet buxhetore për të njëjtën periudhë.
 - Niveli i shërbimeve të ofruara.
 - Nivelin i inflacionit dhe treguesit makroekonomikë fiskalë.
 - Parashikimet për të ardhura të reja dhe transfertave të mundshme nga niveli kombëtar dhe burime të tjera financimi (donacione).
 - Shpenzime të mbartura.
 - Parashikimet e të gjitha të ardhurave për 3-vjeçar, që mbulohen në periudhën e PBA-së.

Analiza financiare për vlerësimin e politikës fiskale


- Pyetjet për analizën e të ardhurave:
 - Sa përkojnë të ardhurat aktuale me të ardhurat e planifikuara?
 - Sa janë të ardhurat për qytetar? Sa është një NJQV e ngjashme? A mund të marrim më shumë?
 - Sa taksapagues kanë kontribuar për buxhetin? Shpërndarja e taksapaguesve?
 - Si është struktura e të ardhurave?
 - Sa është përqindja e bizneseve që nuk kanë paguar taksat?
 - Cili është raporti mes bizneseve të reja dhe atyre të mbyllura?
 - Cili është efekti i inflacionit dhe i rritjes ekonomike në cikle specifike të ardhurash vendore?
 - Cila është pjesa e buxhetit që përbëhet nga të ardhurat e veta? Cila është pjesa e transfertave të pakushtëzuara?

Analiza financiare për vlerësimin e politikës fiskale

Struktura e Burimeve		v.2013	v.2014	v.2015	v.2016
I	Te ardhurat vendore/Te ardhurat ne Total	25%	32%	26%	28%
	Taksat&Tarifat vendore/Totalit te te ardhurave	22%	28%	22%	24%
	Burime te tjera vendore te financimit	2%	4%	3%	3%
II	Te ardhura nga burime Kombetare/Total	75%	68%	74%	72%
	Transferta e pakushtezuar	12%	14%	21%	27%
	Transferta e kushtezuar	63%	54%	54%	45%
	- Per funksionet vendore	0%	0%	0%	3%
	- Per funksionet deleguara	63%	54%	54%	42%

Te ardhurat e veta	v.2013	v.2014	v.2015	v.2016
Transferta e pakushtezuar				
Taksat&Tarifat vendore				
Te trasheguara nga viti meparshem				
Shpenzimet Korente (funksionet e veta)				
- Keshilli Bashkise				
- Administrata e pergjithshme				
- Arsimi				
- Kultura, Sporti				
- Rruge trotuare				
- Pastrimi dhe largimi I mbetjeve				
- Parqet, Vorreza				
- Transpoti publik				
Te tjera shpenzime				
Teprica Deficit/Suficit				

Si ta matim ?



Ushtrim/Shembull




- Llogaritja e te ardhurave sipas IPF (Instrumentit te Planifikimit Financiar) ose mund te përdoret ushtrimi i parapërgatitur kompleks.



PLANIFIKIMI I SHPENZIMEVE

PLANI SHPENZIMEVE TË PROGRAMIT (PSHP)



Planifikimi i Shpenzimeve

- Parashikimet afatmesme duhet të marrin parasysh:
 - ▣ nivelin aktual të shpenzimeve,
 - ▣ shpenzimet shtesë të nevojshme për të siguruar të njëjtin nivel dhe cilësi të shërbimit në të ardhmen (për shembull, si efekt i inflacionit apo rritjes së çmimit për faktorë të rëndësishëm inputi), dhe
 - ▣ shpenzimet shtesë, nëse niveli apo lloji i shërbimit do të përmirësohet. Po ashtu, duhet të analizohet edhe potenciali për fitime nga efikasiteti (procedura më të mira, çmime më të ulëta për faktorët e inputit, kosto më të ulëta administrative, etj.).

Planifikimi i Shpenzimeve

- Kostoja e politikave ekzistuese dhe të reja përfshin në mënyrë të veçantë:
 - kostot e mbajtjes së nivelit aktual të shërbimeve duke marrë parasysh ndryshimet e pritshme në numrin e përdoruesve apo përfituesve,
 - shpenzime të reja të përsëritshme që vijnë nga objektet e reja si efekt i përfundimit të projekteve të investimeve kapitale, dhe
 - kostot e programeve të investimeve në vazhdim, dhe
 - kostot e pritshme të programeve të reja apo projekteve të reja, të cilat planifikohen të miratohen nga njësitë vendore si pasojë e ndikimit të faktorëve të jashtëm (lëvizjet demografike, transferimi i funksioneve të reja) apo vendimeve të brendshme politike (përmirësimi i nivelit të shërbimeve aktuale).

Tabelat e IPF

- IPF prodhon automatikisht 10 tabela dhe gjashtë grafikë në seksionin e saj të produkteve.
- Pamje e të ardhurave në tabelën F1.
- Përpilimi i shpenzimeve në mënyra të ndryshme:
 - Sipas klasifikimit funksional (F2 deri në F5).
 - Sipas klasifikimit programor (F6 deri në F9).
 - Për llojin e aktivitetit, d.m.th., i vazhdueshëm dhe i ri (F10 dhe F11).
 - Sipas klasifikimit ekonomik (F12 dhe F13).

Tabelat e IPF

- IPF i paraqet rezultatet agregate në shifra neto dhe bruto.
- ✓ Shifrat bruto japin informacion për shumën e shpenzimeve të planifikuara në total.
- ✓ Shifrat neto tregojnë sa duhet të paguhet me paratë nga taksat vendore.
- Po ashtu, IPF-ja paraqet bilancin e përgjithshëm financiar (F14), d.m.th., të ardhurat totale, shpenzimet totale dhe fitimin apo humbjen e përgjithshme.

Disa treguesit fiskale sipa IPF

- Totali i shpenzimeve / totali i të ardhurave
- Të ardhura nga taksat / totali i të ardhurave
- Të ardhurat nga tarifat / totali i të ardhurave
- Të ardhura nga gjrobat, pronat, ndërmarrjet dhe teprica e vitit të kaluar / totali i të ardhurave
- Të ardhurat e veta / totali i të ardhurave
- Të ardhurat nga jashtë / totali i të ardhurave

IPF-ja përpilon vetëm informacion financiar. Prezantimi i PBA-së duhet të përmbajë edhe informacion të politikave

Tregues statike

- Të ardhurat nga transferta / totali i të ardhurave në një vit
- Të ardhurat nga taksat / totali i të ardhurave në një vit
- Shpenzimet operative / totali i shpenzimeve në një vit
- Shpenzimet kapitale / totali i shpenzimeve në një vit
- Totali i shpenzimeve / popullsia e NJQV-së

Tregues dinamike

- % e ndryshimit të të ardhurave nga transfertat krahasuara me një vit më parë.
- % e ndryshimit të totalit të shpenzimeve krahasuar me një vit më parë.
- Niveli i ndryshimit të shpenzimeve kapitale krahasuar me një vit më parë.
- % e ndryshimit të të ardhurave për frymë krahasuar me një vit më parë.

Hapat qe ndërmerren për ndërtimin e treguesve

- Përzgjedhja e treguesve të rëndësishëm,
- Përcaktimi i njësisë matëse,
- Përcaktimi i periudhës së referimit,
- Mbledhja e të dhënave dhe llogaritja e treguesve,
- Analizimi dhe interpretimi i të dhënave,
- Prezantimi i rezultateve.

Ushtrim/Shembull



- Llogarisni shpenzimet dhe treguesit financiarë për NJQV-në tuaj dhe krahasoni vlerat me rezultatet për NJQV-në e shokut tuaj.
- Diskutoni ndryshimet.


Ceshtjet

- Buxheti Kapital dhe Plan i Investimeve Kapitale (PIK)
- Hapat për hartimin e Planit të Investimeve Kapitale dhe aktorët kryesorë të përfshirë në proces

Cfare jane Investimet kapitale (1)

- **Jane shpenzime publike** (shpenzime kapitale) qe kryhen nga/ose ne emer te sektorit publik nepermjet investimeve publike:
 - **Te cilat sjellin nje shtese ne aktivet (asetet);**
 - **Kane nje jetegjatesi me te madhe se nje vit;**
 - **Kane vlere me te madhe se 1.000.000 Leke**
- Investimet publike realizohen ne kuader te Programit te Shpenzimeve Publike, i cili eshte:
 - **Nje grup aktivitetesh; qe**
 - Synojne realizmin e nje produkti dhe rezultati te caktuar ;
 - Qe zhvillohet si pjese e nje plani zhvillimi/strategjik ne nje kuader kohor te caktuar
 - Qe menaxhohen ne kuader te ciklit te Menaxhimit te SHP

Cikli i Menaxhimit te Investimeve Publike



Ne cdo faze te ciklit **zbatohen procedura qe** synojne te ndertojne nje proces qe **lidh ne menyre integrale procesin e MI me procesin e pergjithshem te MSHP**

Cfare eshte nje Plan per Investimet Kapitale (PIK)

- PIK eshte nje dokument për pushtetin vendor qe mundeson perkthimin ne terma financiare dhe kohore te strategjise se zhvillimit ekonomik lokal,i dobishëm edhe per negociata me institucione te tjera
- Eshte nje plan afat-gjate per zgjidhjen e nevojave kapitale dhe Pergjigje ndaj qellimeve dhe objektivave per zhvillim
- Fokusohen ne:
 - Perdorimin e tokes
 - Menaxhimin e rritjes
 - Rivitalizimin e komunitetit
- **Nje instrument planifikimi:**
 - Nje liste te projekteve kapitale te propozuara
 - Prioritetet e financimit
 - Vitin ne te cilin nje projekt do te filloje , Shpenzimet vjetore
 - Metodot dhe burimet e financimit

Cfare eshte nje buxhet kapital?

- Prezanton projektet kapitale per vitin e pare te zbatimit te PIK
- Fokusohen ne projektin dhe jo ne njesine e organizimit
- Prezanton mekanizmat e financimit
 - ▣ Buxheti i njqv, bono, hua, subvencione nga buxheti i shtetit, donatore etj.
- Zgjat me shume se nje vit fiskal
- Zakonisht zbatohet nepermjet kontratave me te trete.
- Kerkon planifikim fiskal

Perkufizimi-PIK


PIK tregon:

- Cilat investime duhet te zbatoje Bashkia gjate disa viteve te ardhshme dhe nese Bashkia do te ketë çdo vit para te mjaftueshme për financimet.
- Cilat investime janë dobiprurëse për bashkinë, cilat janë me pak te rëndësishme, dhe cilat mund te shtyhen për te ardhmen dhe se cilat investime janë ide te gabuara dhe duhen braktisur.
- Plani i Investimeve Kapitale **nuk duhet të ngatërrohet me buxhetin e investimeve kapitale**, pasi buxheti investimeve kapitale prezanton vitin e parë të Planit të Investimeve Kapitale.

Objektivi i Procesit të PIK


- **PIK** paraqet **planifikimin** e përmirësimeve kapitale
- Perspektiven **shume vjeçare** ne vend te planifikimit një vjeçar
- Zgjedhja e projekteve kapitale është **objektive**
- **Kritere transparente** për zgjedhjen e projekteve kapitale
- Mjet për zbatimin e **strategjisë** se zhvillimit
- Mjet për **komunikimin me qytetaret** rreth investimeve strategjike me te rëndësishme
- Mjet për **komunikimin me bankat** dhe institucionet e financimit.

Procesi PIK – program 4-5 vjecar investimesh



Procesi PIK – organizimi i punës

88



Hapat per hartimin e PIK (10 hapa)

1. Përcaktimi i strukturës organizative. Kjo strukturë duhet të organizohet brenda njësisë vendore
2. Përcaktimi i rregullave dhe procedurave
3. Hartimi i formularëve dhe udhëzimeve
4. Vlerësimi i nevojave për investime kapitale
5. Analiza e kapaciteteve financiare
6. Identifikimi dhe prioritizimi i projekteve
7. Llogaritja e kostove
8. Vlerësimi i mundësive të financimit
9. Përgatitja e draftit të parë të PIK-ut
10. Paraqitja për miratim i PIK-ut

Percaktimi i struktures organizative



- Organizohet brenda njësisë vendore
- Në krye të struktures do të jetë një prej drejtuesve kryesorë të njësisë (Kryetari/zv. Kryetari) si dhe drejtuesit e (EMP).
- Kjo strukturë është identike me (GSBI).
- Ka antare sa ka programe, përvec drejtuesit.

Percaktimi i rregullave, procedurave

- Justifikimi i perputhjes se investimeve me politikat dhe objektivat e programit;
- Paraqitjen e investimeve me koston e plote;
- Evidentohen koston periodike dhe te ardhurat e shkaktuara nga investimit;
- Analize kosto – perfitim e investimeve;
- Minimizimi i numrit te projekteve me vlere te vogel (nen 1 milion Leke), te cilat mund te financohen ne kuader tjeter shpenzimesh.

Percaktimi i rregullave, procedurave

- Qartësimi i fazave të ciklit të menaxhimit të projektit;
- Menyre qarte e përgatitjes së projekt propozimit dhe plotësimin e formularit përkatës;
- Përcaktimi i rolit të aktoreve të cilët janë përfshirë në proces;
- Analiza dhe vlerësimi i projekteve dhe lidhja e tyre me programin e shpenzimeve publike
- Borxhet për financimin e projekteve të investimeve kapitale duhet të shlyhen para përfundimit të jetës operative të këtyre projekteve.

Çfarë informacioni duhet mbledhur rreth investimeve

- Lidhur me procesin e PIK te paktën informacioni i mëposhtëm duhet mbledhur për çdo propozim investimi
 - Emri i projektit
 - Objektivi i projektit
 - Vendndodhja e projektit
 - Fushat e zbatimit te projektit
 - Kostot e investimit për përgatitjen e projektit (dokumentacioni), përvetësimi i tokës dhe ndërtimi
 - Grafiku i kostove te investimit
 - Burimet e financimit te projekteve
 - Rezultatet e pritshme te projektit (cilësore dhe sasiore)

Parashikimi i të ardhurave dhe i shpenzimeve korrente të buxhetit

□ Parashikimi i te ardhurave

- Te ardhurat planifikohen bazuar ne te ardhurat e vitit te fundit, duke marre parasysh tendencat makroekonomike (rritjen e PBB-se, rritjen e pagave), tendencat vendore (rritjen e popullsisë), përmirësimet e mbledhjes se te ardhurave, futjen e taksave te reja dhe e dyshimeve te njohura ne legjislacion


□ Parashikimi i shpenzimeve korrente

- Shpenzimet korrente parashikohen ne baze te shpenzimeve te vitit te kaluar duke marre parasysh tendencat makroekonomike (rritjen e PBB-se, rritjen e pagave), tendencat vendore (rritjen e popullsisë), ndryshimet e parashikuara ne gamen dhe cilësinë e shërbimeve qe kryhen nga bashkia, vendosjen e detyrave te reja për njësitë e qeverisjes vendore

Teprica Operative

- **Teprica operative** është diferenca ndërmjet et ardhurave te parashikuara (duke përjashtuar te ardhurat kapitale, te tilla si grantet për investime kapitale) dhe shpenzimet korrente (te detyrueshme)
- **Teprica operative** tregon se çfare shume mund te shpenzoje bashkia për investimet kapitale nga burimet e veta dhe për shërbimin e borxhit
- Përbën treguesin kryesor për bankat dhe agjencitë e vlerësimit kur vlerësojnë besueshmërinë për te kredituar një bashki

Financimi i buxhetit kapital



Identifikimi projekteve kapitale

Prioritarizimi i projekteve të identifikuara

Hapat për përzgjedhjen e projekteve të reja

- Si u identifikuan projektet kapitale?
 - Cilat kritere u përdorën për vlerësimin e tyre më tej?
 - A ishin të mjaftueshme kapacitetet financiare për realizimin e tyre?
 - Cilat ishin disa nga zgjidhjet e propozuara?
 - Kush është sfida e NJQV në këtë proces?
- Argumentimi (përse është i nevojshëm) për komunitetin?
 - Kosto (kapitale dhe të mirëmbajtjes)- qëndrueshmëria
 - Produktet/rezultatet (të klasifikuara sipas programit përkatës ku Ekipet e Manaxhimit të Programeve (EPM) përcaktojnë treguesit përkatës të performancës
 - A adresojnë nevojat e grupeve të caktuara vunerabël këto projekte?
 - A adresojnë nevojat e grave në mënyrë specifike?
 - A u përfshinë grupet e interesit dhe nëse po si?
- Rivlerësimi i projekteve të parashikuara në PSZH (matja e statusit-përfunduar/në vazhdim)
 - Cilat janë sfidat e sotme të monitorimit
 - Vlerësimi i kushteve ekzistuese të infrastrukturës
 - Vlerësimi i nevojave të tjera për investime kapitale si psh. projekt urban, projekt zhvillimi etj...dinamikat në ndryshim sociale dhe ekonomike
 - Çfarë rekomandimesh mund të propozohen?

Perse duhet renditja dhe zgjedhja e investimeve?

- Nevojat e pushtetit vendor për investime kapitale janë gjithnjë me te mëdha krahasuar me burimet e financimit që ato mund të sigurojnë
- Renditja kërkon të ulë motivimet subjektive për zgjedhjen e projekteve - zëvendësimi i konsideratave politike (afatshkurtër) me kritere objektive.
- Renditja „fikson” zgjedhjet e investimeve që mund të zgjaten tej afateve të mandateve të posteve politike - krijon nxitje për të menduar me afatgjatë.
- Duhet të përziejë kriteret ekonomike (p.sh., kostot operative dhe kriteret jo ekonomike (p.sh., përqindja e popullsisë së shërbyer)

Perzgjedhja e projekteve per investime

- Analizohen tri fusha të gjera në një rend logjik përparësie:

Faza e pare:

- (1) Vlerësimi rast pas rasti i projekteve aktualisht në zbatim: projektet e filluara tashmë që nuk do të përfundohen në vitin aktual, do të përfshihen në PIK-un tjetër.
- (2) Vlerësimi i kushteve ekzistuese të infrastrukturës: identifikimi i nevojave të rëndësishme dhe urgjente për rehabilitimin e infrastrukturës.
- (3) Vlerësimi i nevojave shtesë për investime kapitale: p.sh., projekte të zhvillimit urban, krijimi i hapësirave të lira, strehimi social, krijimi i hapësirave të reja të parkimit etj.

Faza e dyte:

- a) Projektet në vazhdim jashtë fushe (1) futen pothuajse automatikisht në PIK, për pikat (2) dhe (3) duhet më shumë orientim për përzgjedhjen e projekteve.
- b) **Lista e kriterëve për përzgjedhjen e projekteve për investimet kapitale**

Kriteret për përzgjedhjen e investimeve

- Projekti duhet të jetë funksion i vetë njësisë .
- Kontributi në përmbushjen e objektivit/ objektivave strategjike.
- Numri i përfituesve apo zona që përfiton.
- Ndikimi në ekonominë vendore / rajonale
- Shkalla e urgjencës së projektit.
- Statusi i projektit (“i ri” ose “në vazhdim”).
- Shpërndarja e kostos në kohë dhe midis kategorive taksapaguese.
- Gjenerimi i të ardhurave nga projekti dhe mundësia për rikuperimin e kostos.
- Marrëdhëniet me projektet e tjera.
- Mundësia e financimit nga burime financiare të jashtme (donator, qeveri, biznes).

Kriteret për prioritizimin e investimeve

CAKTIMI I KRITEREVE

- Identifikimi i të gjitha kriterëve
- Përzgjedhja e grupit të kriterëve
- Kontrolli i plotësisë
- Mjaftueshmëria
- Pavarësia e dyanshme
- Numur i tepërt kriteresh

CAKTIMI I PIKEVE

- Caktimi i shkallëve numerike për kriteret e vlerësimit
- Përcaktimi i vlerave mbi shkallën interval p.sh. (nga 0-10 pikë)

PESHA

- Përkufizimi i rëndësisë relative të kriterëve

RENDITJA

- Kombinimi i peshave dhe pikëve
- Renditja e projektit

Prioritizimi i projekteve sipas pikeve

Shëmbull prioritizimi i projekteve	Shuma totale e projektit të propozuar	Pikët totale
Projekti 1	€ 240,000	99
Projekti 2	€ 190,000	95
Projekti 3	€ 400,000	90
Projekti 4	€ 150,000	80
Etc.....	€	78
Total	€	


Vlera Totale e kërkuar

Pragu

Rishikimi (Analiza),
Miratimi dhe Financimi i
Projekt- Propozimeve te Investimeve Publike

- ✓ Shqyrtimi i propozimeve për investim nëpërmjet procesit të rishikimit të PBA-se/Buxhetit Vjetor nga Grupi i Menaxhimit (Rishikimit) të Buxhetit (projektet e vogla)
- ✓ Miratimi i financimit dhe përfshirja në PBA/Buxhetin Vjetor

Procesi i buxhetit kapital



Aktoret e përfshire ne proces

- Dëgjesa Publike
 - ▣ **Avantazhet:** Duke qenë metoda më e përhapur, dëgjesa publike organizohet si takim formal i hapur për të gjithë aktorët e interesuar. Zakonisht kjo është mundësia e fundit e qytetarëve për të dhënë mendimin e tyre para miratimit nga të zgjedhurit vendorë.
 - ▣ **Disavantazhet:** Nuk është një forum i përshtatshëm për trajtimin e ideve komplekse ose informacionit të detajuar. Po ashtu, dëgjesat publike mund të dominohen nga individë apo grupe me interesa të veçanta.
- Anketat qytetare
 - ▣ **Avantazhi:** Është mënyrë e shpejtë dhe e sigurt për të marrë mendimin e saktë dhe të shpejtë nga qytetarët.
 - ▣ **Disavantazhi:** Kosto e lartë; çon në inflacion dëshirash

Aktoret e përfshire ne proces

- Grupe fokusimi
